

Të drejtat e komuniteteve në Kosovë

Prill
2021



Karakteristikat e shoqërisë së hapur në komunitetin serb të Kosovës

A janë dhe sa të hapura mediat serbe në Kosovë

Organizatat e shoqërisë civile në komunitetin serb të Kosovës – Në mes të perceptimit dhe prezantimit

Partitë politike të serbëve të Kosovës në sistemin politik të Kosovës: Nga pluralizmi deri te monizmi

Qëndrimet e Serbëve të Kosovës mbi institucionet e sigurisë

Qasshmëria e institucioneve për qytetarët në Kosovë

Të drejtat e komuniteteve në Kosovë

Serbët e Kosovës në procesin e dialogut

Analiza e gjendjes ekonomike të komunitetit serb në Kosovë

Titulli i hulumtimit: Të drejtat e komuniteteve në Kosovë

Botues: KFOS

Për botuesin: OJQ AKTIV, CRMC

Autori: Caleb Waugh, Darko Dimitrijeviq

Gjuha origjinale në të cilën është punuar analiza është gjuha Serbe.

Përkthyer: Xhenana Azizi

Dizajn: tedel

Shtypshkronja (Tirazhi): tedel (100)

Ky botim u realizua në kuadër të projektit OPEN të implementuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) në bashkëpunim me organizatat OJQ AKTIV dhe CRMC. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorëve të hulumtimit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e KFOS.

Viti i botimit: : 2021

PËRMBAJTJA

01.

METODOLOGJIA DHE MODELI I HULUMTIMIT SASIOR	6
--	----------

Metodologjia dhe dizajni i kërkimit cilësor	7
--	---

02.

HYRJE	8
--------------	----------

Rreth hulumtimit	8
------------------	---

Rreth partnerëve	8
------------------	---

03.

PËRMBLEDHJE	9
--------------------	----------

Metodologjia e hulumtimit	10
---------------------------	----

Gjetjet kyçe	10
--------------	----

04.

TË DREJTAT E KOMUNITETEVE NË KOSOVË	12
--	-----------

Historiku ligjor i të drejtave të komuniteteve	12
---	----

Problemet në zbatimin e legjislacionit: Mes teorisë dhe praktikës	13
---	----

Pandemia COVID-19 dhe të drejtat e komuniteteve	14
--	----

Rezultatet e sondazheve të opinionit publik mbi perceptimin e të drejtave të komuniteteve Përmbledhje e rezultateve	15
--	----

Besimi në institucionet publike	16
---------------------------------	----

Qasja në informacion	19
----------------------	----

Besimi në akterët institucionalë dhe politikë	21
--	----

Përvoja institucionale	21
------------------------	----

05.

PËRFUNDIMET	24
--------------------	-----------

Rekomandime	25
-------------	----

1. Metodologjia dhe modeli i hulumtimit sasior

Anketimi ballë për ballë në terren u realizua në periudhën nga 1 deri më 20 tetor 2020. Gjithsej 582 qytetarë serb u anketuan në të gjithë Kosovën. 50.5% e të anketuarve janë anketuar në jug të lumit Ibër, ndërsa 49.5% e të anketuarve janë anketuar në veri të lumit Ibër. Pyetësi përbëhej nga 65 pyetje dhe përfshinte gjithsej 8 fusha. Mostra ishte e qëllimshme, me kuotë, dhe kriteri për përcaktimin e kuotave ishte madhësia e komunës së të anketuarit. Intervali i besimit është +/- 5. Në mostër, kishte gjithsej 54.7% meshkuj dhe 45.3% femra. Moshë mesatare e

të anketuarve është 44 vjeç. Me arsim fillor ishin 14.4% të të anketuarve, 62.1% me arsim të mesme dhe 23.5% me arsim të lartë, pra fakultet. Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve, 25.9% janë të punësuar në sektorin publik, 22.3% në sektorin privat, 35.2% janë të papunë, ndërsa 16.6% janë në pension. Është e rëndësishme të theksohet se duke pasur parasysh faktin se nuk ka statistika zyrtare mbi strukturën demografike të popullsisë së synuar, pra të popullsisë serbe në Kosovë, vetëm kushtimisht mund të flasim për përfaqësim të mostrës.

Metodologjia dhe dizajni i kërkimit cilësor

GRUPET E FOKUSIT

Grupet e fokusit

Hulumtimi u realizua nga muaji korrik deri në tetor 2020.

Instrumenti i hulumtimit:

Një udhëzues bisede me 20 pyetje

Numri i grupeve të fokusit:

8 Fokus grupe

Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve:

80 pjesëmarrës (10 pjesëmarrës në secilin fokus grup)

Kriteret për përzgjedhjen e pjesëmarrësve:

Katër grupe fokusi u mbajtën me 'ekspertë' nga sektori i organizatave joqeveritare që merren drejtpërdrejt me të drejtat e komuniteteve jo-shumicë dhe katër me qytetarë 'të zakonshëm' (d.m.th me pjesëtarët e komunitetit lokal).

INTERVISTAT

Periudha:

Hulumtimi u realizua nga shtatori deri në tetor 2020

Instrumenti i hulumtimit:

Udhëzues për intervistë me 10 pyetje

Numri i përgjithshëm i të intervistuarve:

10 të intervistuar

Kriteret për zgjedhjen e bashkëbiseduesve:

Njohja e gjendjes së të drejtave të komuniteteve në Kosovë, njohja e legjislacionit.

Bashkëbiseduesit:

Të gjitha intervistat ishin anonime.

2. Hyrje

Rreth hulumtimit

Më shumë se njëzet vjet pas luftës dhe shtatë vjet nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Brukselit, komuniteti serb i Kosovës ende e gjen vetën në një lloj vakumi, i ngjuar në mes të interesave të trefishtë të palëve të përfshira (Prishtinës, Beogradit dhe bashkësisë ndërkombëtare) dhe kryesisht i shkëputur nga jeta publike, pozicioni i të cilit ende nuk është përcaktuar mirë, dhe mundësia e pjesëmarrjes aktive në procesin e vendimmarrjes has në pengesa. Megjithëse, nga një këndvështrim zyrtar, mbrohet dhe përfaqësohet mirë, realiteti ndryshon në mënyrë drastike nga ajo që për momentin është 'në letër'.

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të shqyrtojë pikëpamjet e pjesëtarëve të komunitetit serb të Kosovës në lidhje me marrëdhëniet e tyre me strukturat institucionale dhe të qeverisë së Kosovës dhe të përcaktojë shkallën në të cilën ato struktura janë të gatshme të njohin dhe mbrojnë në mënyrë adekuate të drejtat e tyre ligjore dhe kushtetuese. Studimi shqyrton perceptimet rreth pozitës së tyre aktuale brenda Kosovës dhe shkallën në të cilën ata mendojnë se interesat e komunitetit të tyre/interesat e tyre kolektivë përfaqësohen në mënyrë adekuate në nivelin politik. Si përfundim i përgjithshëm, ky studim do të kërkojë të përcaktojë shkallën në të cilën sistemet aktuale institucionale dhe politike janë të gatshme të integrojnë dhe pranojnë sërish të Kosovës dhe nëse sërish të Kosovës janë të gatshëm të marrin pjesë në atë sistem.

Rreth partnerëve

OJQ AKTIV është organizatë e shoqërisë civile me seli në Mitrovicën e Veriut. Misioni i AKTIV-it është të mundësojë përfshirjen kuptimplotë të komunitetit serb të Kosovës në nxitjen e një të ardhme pjesëmarrëse, paqësore dhe prosperuese në rajon. Për të realizuar këtë qëllim, AKTIV ka përcaktuar disa fusha kryesore për angazhim që janë edhe objektiva të organizatës. Këto objektiva janë: (1) Të sigurohet një kornizë gjithëpërfshirëse dhe e qëndrueshme për pjesëmarrje të plotë të qytetarëve në procese vendimmarrëse në nivel lokal dhe qendror në Kosovë, (2) Të përmirësohen marrëdhëniet ndër-komunitare në Kosovë; (3) Të lehtësohet progresi i qëndrueshëm ekonomik i komuniteteve në Kosovës përmes bashkëpunimit të zgjeruar etnik dhe (4) Të rigjallërohet tradita lokale e angazhimit pozitiv kulturor.

Qendra për të Drejtat e Komuniteteve të Pakicave (CRMC - The Center for the Rights of Minority Communities) është organizatë joqeveritare me seli në Gorazhdec (komuna e Pejës) e cila merret me promovimin e të drejtave dhe pozitës së përgjithshme të komuniteteve jo-shumicë në Kosovë përmes fushatave të ndërgjegjësimit dhe punës së drejtpërdrejt me aktivistët lokalë. CRMC përqendron punën e saj në fushat që përndryshe janë neglizhuar nga palët e interesuara politike dhe ndërkombëtare, siç janë komunitetet e të kthyerve në Kosovën perëndimore.

3. Përmbledhje

Kosova shtrihet në një zonë me dinamikë jashtëzakonisht të ndërlikuar shoqërore, politike dhe etnike, që në të vërtetë ka qenë burim i tensioneve historike midis grupeve që jetojnë brenda saj dhe vazhdon të paraqesë një sfidë të vazhdueshme për politikëbërësit dhe bashkësinë ndërkombëtare. Shteti që u themelua pas luftërave në fund të viteve 90-ta ishte, në shumë aspekte, produkt i një projekti të lancuar nga komuniteti ndërkombëtar që synonte të përfshinte shumë parime, norma dhe standarde që konsideroheshin kyçe për krijimin e një shoqërie funksionale dhe demokratike. Një aspekt i rëndësishëm i kësaj, ishte përkushtimi për të drejtat e pakicave, ose më mirë, në rastin e Kosovës, komuniteteve 'jo-shumicë' brenda kornizave ligjore dhe kushtetuese të Kosovës. Me rëndësi të veçantë ishte pozicioni i komunitetit serb të Kosovës, i cili pas konfliktit u gjend i izoluar dhe i rrethuar, si dhe i ngujuar midis ndikimit konkurrues të qeverisë në Prishtinë dhe qeverisë në Beograd.

Koncepti i 'të drejtave të pakicave' kryesisht kuptohet se i referohet të drejtave individuale dhe kolektive - e drejta individuale për përdorimin e gjuhës, praktikimit të fesë dhe traditave, dhe e drejta kolektive për të afirmuar dhe ruajtur një identitet të veçantë ose një grup identitetesh.¹ Në rastin e Kosovës, ky parim i mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve specifike, përveç shumicës, zë një vend thelbësor (të paktën në teori)

1 <https://web.archive.org/web/20120106024749/http://www2.ohchr.org/english/law/minorities.htm>. I qasshëm më 25 shtator 2020.

në filozofinë e saj qeverisëse. Në përputhje me këto udhëzime, gjerësia dhe shtrirja e të drejtave të dhëna komuniteteve janë domethënëse në Kosovë, duke përfshirë garantitë e të paktën një shkalle të kufizuar të vetëvendosjes në çështjet lokale apo të komunitetit.² Pyetja thelbësore që ngrihet këtu, dhe e cila do të trajtohet më vonë në këtë punim, është se sa e gjithë kjo ka arritur të përmirësoj atmosferën në të cilën serbët në Kosovë mendojnë se të drejtat e tyre të komunitetit janë të mbrojtura dhe a mendojnë se interesat e tyre (politikisht) përfaqësohen në mënyrë adekuate?

Edhe pse në Kosovë ka një numër të komuniteteve të ashtuquajtura jo-shumicë³, serbët deri më tani përbëjnë grupin më të madh etnik jo-shqiptar.⁴ Përfshirja dhe integrimi i tyre në strukturat institucionale dhe politike të Kosovës është veçanërisht sfiduese dhe shqetësuese për komunitetin ndërkombëtar, ashtu si edhe aftësia e qeverisë dhe institucioneve të saj për të zbatuar dhe respektuar plotësisht të drejtat e tyre në praktikën e përditshme. Siç u tha, komuniteti serb i Kosovës po ballafaqohet me vështirësi so-

2 Megjithëse shpesh kuptohet si referimi i idesë që kombet individuale kanë të drejtë të vendosin sovranitet mbi një territor të caktuar në procesin e vendosjes së pavarësisë dhe vetëqeverisjes, kjo gjithashtu mund t'i referohet të drejtave të kombeve brenda shteteve për të vendosur një shkallë të autonomisë mbi vendimmarrjen që prek interesat e tyre të komunitetit.

3 Komuniteti jo-shumicë është një term përdorimi i të cilit është kryesisht i kufizuar në Kosovë dhe i referohet grupeve etnike të ndryshme nga shumica shqiptare. Kjo mund dhe duhet të përfshijë serbë, romë, ashkali, egjiptianë, turq, boshnjakë, malazezë dhe kroatë.

4 https://www.cia.gov/library/publications/the-world-fact-book/geos/print_kv.html

cio-ekonomike, politike dhe vështirësi të tjera, të cilat janë kryesisht rezultat i faktit se komuniteti e gjen vetën në një konflikt politik midis dy palëve dhe mungesës së vullnetit dhe/ose gatishmërisë së autoriteteve të Kosovës për të marrë seriozisht detyrimet ligjore ndaj tyre (serbëve).

Ky studim, përmes një analize të kombinuar të hulumtimit cilësor dhe sasior do të përpiqet të shqyrtojë gjendjen e të drejtave të komuniteteve në Kosovë me qëllim të vlerësimit të shkallës në të cilën serbët gëzojnë të drejtat që u garantohen nga korniza legjislative e Kosovës. Gjithashtu do të analizojë se si serbët që jetojnë në Kosovë i perceptojnë këto të drejta, si dhe natyrën e marrëdhënies së tyre me qeverinë, institucionet dhe përfaqësuesit politikë.

Metodologjia e hulumtimit

Puna kërkimore filloi në muajin shtator 2020 si një bashkëpunim midis OJQ Aktiv nga Mitrovica e Veriut dhe Qendrës për të Drejtat e Komuniteteve Pakicë nga Gorazhdec (Pejë). Studimi parashikoi elementet sasiore dhe cilësore, me intervista dhe grupe të fokusit të mbajtura në zonat me shumicë serbe në veri dhe në jug të lumit Ibër. U mbajtën gjithsej tetë (8) grupe të fokusit, katër (4) me ekspertë në fushën e të drejtave të komuniteteve (aktivistë lokal, përfaqësues të shoqërisë civile dhe ekspertë ligjorë) dhe katër (4) me qytetarë. Nga një perspektivë gjeografike, katër (4) u mbajtën në komunat veriore dhe dy (2) të tjera në zonën e Graçanicës, një në rajonin e Gjilanit dhe një tjetër në komunën e Pejës. Një grup i ngjashëm pyetjesh u përdor për të gjitha grupet e fokusit, me pyetje për ekspertët të përshtatura me njohuritë dhe përvojën e tyre në këtë fushë. Për më tepër, dymbëdhjetë (12) intervista ballë për ballë janë realizuar me individë të përfshirë drejtpërdrejt në fushën e të drejtave të komuniteteve jo-shumicë në Kosovë. Në fund, rezultatet e një sondazhi të opinionit publik që mbuluan një varg çështjesh të ndryshme u përdorën për të konfirmuar/vërtetuar rezultatet e hulumtimit cilësor të realizuar.

Gjetjet kyçe

Mungesa e besimit:

- Qytetarët duket se kanë nivel më të lartë **mosbesimi** (bazuar në përvojën personale) **në polici dhe në sistemin gjyqësor** - për faktin se të dyja këto organe nuk ofrojnë komunikim me shkrim dhe/ose me gojë në gjuhën serbe;
- Shumë të anketuar theksuan ndërveprime negative me Policinë e Kosovës dhe refuzimin/pamundësinë e saj për të komunikuar me ta në gjuhën serbe;

Përvoja dhe ndërveprimet institucionale

- **Veriu karshi Jugut:** Banorët e komunave në jug të lumit Ibër, veçanërisht ata në Kosovën perëndimore dhe lindore, raportojnë probleme të drejtpërdrejta me institucione, ndërsa ata të veriut janë të vetëdijshëm për problemet e tilla mirëpo personalisht nuk i kanë përjetuar;
- Për sa i përket qasjes në shërbime pa shumë pengesa, banorët e komunave veriore (Mitrovica e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq) **flasin për ndërveprime më pozitive me institucione sesa ata në jug të lumit Ibër;**
- Në përgjithësi, hulumtimi tregon se shumica e qytetarëve raportojnë probleme me institucionet e nivelit qendror (d.m.th. Ministrinë) dhe **konsiderojnë se qeveritë lokale (p.sh. komunat) janë më të përgjegjshme ndaj nevojave të tyre** (qasja në shërbime);
- Banorët që kishin pasur kontakt me mekanizma të tillë si Institucioni i Avokatit të Popullit, **pretendojnë se përvojat e tyre ishin kryesisht pozitive** dhe se të njëjti me sukses ofroi ndihmën adekuate;
- Banorët e komunave me shumicë shqiptare (p.sh. në Pejë) duket se kanë më shumë probleme në ndërveprim me institucione dhe qasje në shërbime dhe informacione në gjuhën serbe;
- Institucionet janë kryesisht të pa interesuara për të ofruar mbështetjen dhe qasjen e duhur në shërbime;

- Edhe pse Kuvendi i Kosovës u veçua si një organ që vazhdimisht shkel Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve, **në një grup të fokusit u tha se Zyra e Presidentit ishte një shembull pozitiv i një institucioni që respekton të drejtat gjuhësore;**

Njohja dhe kuptimi i të drejtave

- Banorët e komunave në jug të lumit Ibër duket se janë **më të vetëdijshëm për të drejtat e tyre ligjore sesa ata në veri** - siç thuhet nga pjesëmarrësit në veri, kjo të paktën pjesërisht për shkak të faktit se ata nuk kishin nevojë të vinin në kontakt me institucionet e nivelit qendror;
- Megjithëse ekziston një vetëdije e përgjithshme për të drejtat ligjore (d.m.th. që gjuha serbe është gjuhë zyrtare) **banorët shpesh nuk e njohin ligjin në detaje dhe nuk janë të vetëdijshëm për mekanizmat në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tyre;**
- Të anketuarit shpesh theksuan **mungesën e burimeve të disponueshme dhe vullnetin e vetë qytetarëve për t'u informuar për të drejtat e tyre, dhe në veçanti për mungesën mbizotëruese të interesit tek të rinjtë;**
- Në një numër rastesh të ndryshme, komuniteti serb në Kosovë u përshkrua si 'pasiv' dhe në mungesë të vullnetit/fuqisë/aftësisë për të mbrojtur në mënyrë aktive të drejtat e tij dhe për të "kërkuar drejtësi" - kjo shpesh ishte dhënë si një arsye (e pjesshme) për zbatimin e dobët dhe respektimin e legjislacionit që rregullon të drejtat e komuniteteve jo-shumicë.

Zbatimi

- Në mesin e ekspertëve **ekziston një konsensus mbizotërues për sa i përket ligjit dhe Kushtetutës së Kosovës: të drejtat e pakicave janë SHUMË mirë të mbrojtura**, dhe në përputhje me të gjitha normat ndërkombëtare dhe praktikat më të mira, POR asnjëherë nuk zbatohen si duhet në praktikë;
- Disa të anketuar theksuan faktin se institucio-

net nuk kanë kapacitete teknike për të zbatuar ligjin, e në veçanti Ligjin për përdorimin e gjuhëve;

- Të tjerët theksuan si nga ana e institucioneve ashtu edhe nga publiku i gjerë.

Përfaqësimi politik

- Banorët shpesh mendojnë se problemet **janë të zgjidhshme, por që vullneti politik për adresimin/zgjidhjen e tyre në mënyrë sistematike mungon** (si tek serbët e Kosovës ashtu edhe tek shqiptarët e Kosovës);
- Nga të gjithë pjesëmarrësit në grupet e fokusit dhe të intervistuarit **pothuajse asnjë i anketuar/pjesëmarrës nuk tha që ata e konsiderojnë se përfaqësuesit e tyre politikë (d.m.th. ata të komunitetit serb të Kosovës) i përfaqësojnë në mënyrë adekuate interesat e tyre në nivel qendror.**

Rekomandimet kyçe

- Fushata më të avancuara dhe më intensive të informimit publik.
- Qasje më të lehtësuara dhe më të disponueshme në informacion.
- Ndërlidhje, komunikim dhe koordinim më të mirë dhe më të shpeshtë ndërmjet institucioneve të nivelit qendror dhe komuniteteve lokale.
- Lidhje dhe kanale më të mira të komunikimit ndërmjet mediave në gjuhën serbe dhe institucioneve qeverisëse.

4. Të drejtat e komuniteteve në Kosovë

Historiku ligjor i të drejtave të komunitete

Ky studim nuk do të ofrojë një analizë të hollësishme ligjore të legjislacionit në lidhje me të drejtat e komuniteteve, por përkundrazi do të kërkojë të ofrojë një pasqyrë të shkurtër të asaj që ky studim kërkon të vlerësojë në nivelin shoqëror. Me fjalë të tjera, për të përshkruar në terma të gjerë pozitën ligjore të komuniteteve jo-shumicë dhe më pas për të analizuar perceptimin e pjesëmarrësve për respektimin e këtyre të drejtave në praktikë.

Kosova nga Kushtetuta e saj përcaktohet si *shumetnike*⁵ në natyrë dhe shoqëria karakterizohet si *civile*, jo etnike ose kombëtare.⁶ Kushtetuta gjithashtu garanton lirinë e shprehjes, fesë dhe tubimit, së bashku me të drejtat e tjera themelore.⁷ Në veçanti për komunitetet jo-shumicë, gjuha serbe përcaktohet si një gjuhë zyrtare që është ligjërisht e barabartë me shqipen (në nivel qendror dhe atë lokal), dhe gjuha boshnjake, rome dhe turke janë "gjuhë në përdorim zyrtar" në komunitat ku ato grupe përbëjnë

5 Kushtetutat e Shqipërisë dhe Kroacisë përmbajnë një referencë për kombësinë shqiptare dhe kroate dhe lidhjen e tyre me ato vende

6 "Republika e Kosovës është shoqëri shumëtnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore". Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 3 (Barazia para ligjit)

7 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli I, Dispozita Themelore

një përqindje të caktuar e popullsisë.⁸ Të drejtat gjuhësore shtjellohen më tej në Ligjin për përdorimin e gjuhëve që përcakton udhëzime të rrepta për dygjuhësinë në institucionet e Kosovës dhe madje edhe në sektorin privat. Kapitulli III (Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre) merret drejtpërdrejt me të drejtat e komuniteteve dhe u siguron atyre mbrojtje nga diskriminimi.⁹ Kapitulli III gjithashtu garanton që pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë kanë të drejtë të zhvillojnë dhe avancojnë lirisht identitetin dhe atributet e tyre si komunitet.¹⁰ Përveç kësaj, ai gjithashtu garanton të drejtën për të shprehur, mbajtur dhe zhvilluar kulturën dhe traditat, arsimin në gjuhën e tyre amtare; përdorimin e simboleve të komunitetit, përdorimin e alfabetit amtar, përfaqësimin në transmetim dhe krijimin e lidhjeve me vendet/shtetet që ndajnë kulturën dhe trashëgimin e tyre.¹¹

Përveç të drejtave të përshkruara më sipër, kushtetuta garanton përfaqësim të barabartë të komuniteteve jo-shumicë në nivele të ndryshme të qeverisjes duke respektuar në të njëjtën kohë rregullat të ndryshme që e detyrojnë shtetin të sigurojë që ata të jenë të pranishëm në organet institucionale dhe organet e tjera publike.¹² Në bazë të kësaj, Kapitulli IV i Kushtetutës parashikon që komuniteti serb duhet të ketë dhjetë (10)

8 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli I, Dispozita Themelore

9 Ibid, Kapitulli III, Neni 58 (Përgjegjësitë e Shtetit)

10 Ibid, Kapitulli III, Neni 57 (Parimet e Përgjithshme)

11 Ibid, Kapitulli III, Neni 59 (Përgjegjësitë e Shtetit)

12 Ibid, Kapitulli III, Neni 59 (Përgjegjësitë e Shtetit)

vende të rezervuara në Kuvendin Kombëtar, ndërsa komunitetet romë/ashkali/egjiptian duhet të kenë katër (4), komunitetet boshnjake dhe turke tre (3) secili dhe komuniteti goran një (1).¹³

Pjesë të tjera kryesore të legjislacionit që kanë të bëjnë me të drejtat e komuniteteve janë Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe anëtarëve të tyre në Kosovë dhe Ligji për përdorimin e gjuhëve.¹⁴ Ligji për përdorimin e gjuhëve siguron barazinë ndërmjet gjuhës shqipe dhe serbe në të gjitha nivelet e jetës publike dhe garanton të drejtën për të u qasur në dokumente, informacione dhe shërbime në të dy gjuhët. Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe anëtarëve të tyre në Kosovë përmban përcaktime të mëtejshme mbi të drejtën për nxitjen dhe identitetin kulturor, duke theksuar se: "Komunitetet dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë që lirisht të kultivojnë, shprehin dhe zhvillojnë kulturën dhe identitetin e tyre dhe të ruajnë e përmirësojnë elementët esencialë të identitetit të tyre, veçanërisht fenë, gjuhën, traditat dhe trashëgiminë e tyre kulturore".¹⁵

Problemet në zbatimin e legjislacionit: Mes teorisë dhe praktikës

ASiç shihet në kornizën ligjore dhe kushtetuese të Kosovës, mbrojtja e ofruar për komunitetet jo-shumicë është e gjerë dhe në përputhje me, mbase edhe me standarde më të avancuara evropiane dhe ndërkombëtare kur bëhet fjalë për të drejtat e pakicave. Ky është një vlerësim mjaft objektiv, në fakt, një vlerësim që ndahet nga shumë akterë të shoqërisë civile brenda komunitetit serb të Kosovës.¹⁶ Ekzistenca e një baze të fortë ligjore për të drejtat e komuniteteve nuk përkethehet domosdoshmërisht nga teoria në praktikë dhe provat për shkelje të këtyre të drejtave në Kosovë janë të shumta.¹⁷ Siç u tha nga një pjesëmarrës në një fokus grup të kryer si pjesë

e këtij studimi: "Kjo temë është prezente për njëzet vitet e fundit. Në letër, gjithçka është në rregull, por në terren, në fakt, asgjë nuk zbatohet."¹⁸ Përderisa është e vështirë të diskutohet që zbatimi ndryshon në mënyrë drastike nga ajo që është aktualisht në letër, është e vështirë të përcaktohet se si ndikon ky realitet në mënyrën se si serbët e Kosovës dhe komunitetet e tjera jo-shumicë perceptojnë marrëdhëniet e tyre me institucionet dhe akterët politikë. Kjo ndërlkohet më tej nga ndjenjat paraprake të apatisë politike, të shoqëruara me një rezervë të përgjithësuar kur bëhet fjalë për pjesëmarrjen në jetën institucionale dhe politike të Kosovës - duke e bërë sfiduese ndarjen e mungesës së përgjithshme të njohurive dhe/ose interesit me pjesëmarrje në sistemin e Kosovës dhe pikëpamjet e shkeljeve të të drejtave. Edhe më të ngatërruara janë arsyet e mungesës së zbatimit të ligjeve për të drejtat e jo-shumicës, pavarësisht nëse bëhet fjalë për një diskriminim të qëllimshëm, mungesa e burimeve dhe/ose vullnetit politik është diçka që shpesh përcaktohet në mënyrë subjektive dhe bazohet në supozime të mëparshme. Në përgjithësi, dhe gjatë gjithë këtij studimi, një grup rrethanash si mungesa e vullnetit politik dhe burimeve (materiale/financiare) për zbatimin e ligjit në mënyrën e paraparë u identifikuan si përcaktues të një dinamike të ngjarjeve: pjesëmarrësit e hulumtimit përshkruan një sërë problemesh, duke filluar nga mungesa e përkthimeve dhe disponueshmëria e informacionit në gjuhën serbe, e deri te rritja e incidenteve të dhunshme që nga fillimi i pandemisë COVID-19.¹⁹ Ky hulumtim gjithashtu zbuloi probleme të përhapura në marrjen e dokumenteve personale²⁰ si dhe se gjykatat që nuk janë të gatshme dhe/ose nuk janë në gjendje të lëshojnë vendime dhe dokumente në gjuhën serbe.²¹ Kjo konfirmon hulumtimet e mëparshëm të kryera nga organizata joqeveritare, të cilat identifikuan çështje të rëndësishme me të cilat për-

13 Ibid, Kapitulli IV, Neni 64 (Struktura e Kuvendit)

14 Ibid, Kapitulli IV, Neni 64 (Struktura e Kuvendit)

15 Ligji Nr. 03 / L-047 Për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Anëtarëve të Tyre, Neni 2 (Identiteti)

16 Siç pasqyrohet në deklaratat e bëra gjatë grupeve të fokusit me ekspertë dhe aktivistë të shoqërisë civile në Çagllavicë dhe Graçanicë, të mbajtura me datë 6 tetor 2020.

17 Mësimet e nxjerra: Trajtimi i komuniteteve jo-shumicë të Kosovës gjatë pandemisë COVID-19, OJQ Aktiv, Mitrovica e Veriut, 2020.

18 Një deklaratë e bërë nga një pjesëmarrës gjatë një fokus grupi në Çagllavicë të mbajtur më 6 tetor 2020 nga Qendra për të Drejtat e Komuniteteve të Pakicave.

19 Bazuar në hulumtimin e kryer nga OJQ CMPZ në Gorazhdec i cili vuri në dukje një rritje të sulmeve ndaj pronës serbe, si dhe sulmeve fizike që mbetën të pazgjithdhura deri në publikimin e këtij raporti.

20 Bazuar në hulumtimin e kryer nga OJQ CMPZ në Gorazhdec i cili vuri në dukje një rritje të sulmeve ndaj pronës serbe, si dhe sulmeve fizike që mbetën të pazgjithdhura deri në publikimin e këtij raporti.

21 IBID

ballen pjesëtarët e komuniteteve pakicë, nga shkeljet e të drejtave gjuhësore deri te boshllëqet e mëdha në zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve.²²²³²⁴ Në pothuajse të gjitha rastet, këto probleme kanë tendencë të ekzistojnë në një nivel institucional, që do të thotë se ato kanë një efekt të pritjes kur bëhet fjalë për qasje në shërbimet themelore.

Si një shembull më konkret i kësaj, pjesëmarrësit në hulumtime cilësore (intervistat dhe fokus grupet) në shumë pjesë të Kosovës, posaçërisht në rajonin e Pejës, deklaruan se hasin në probleme të shumta kur bashkëveprojnë me institucione publike, veçanërisht kur bëhet fjalë për qasje në dokumente dhe/ose shërbime në gjuhën e tyre amtare. Komunitat dhe institucionet e tjera lokale, si dhe gjykatat dhe policia u cituan si veçanërisht problematike. Edhe pse në Ligjin për përdorimin e gjuhëve (nr. 02/L-37 neni 14) theksohet se gjykatat kanë për detyrë të lëshojnë dokumente të cilat kanë të bëjnë me procedurat në gjuhën(t) zyrtare të zgjedhur për procedurë, por në praktikë, vendimet e gjykatave zakonisht lëshohen në shqip. Një pjesëmarrës në një fokus grup deklaroi se kontrata e tij bankare ishte anuluar kur u konstatua se ai e kishte nënshkruar duke përdorur alfabetin cirilik. Më tej, pas analizës së tenderëve publik dhe njoftimeve për vendet e lira të punës u vërtetua se ato shpallen edhe në mungesë të përkthimeve në gjuhën serbe, kështu duke privuar banorët që nuk flasin ose kuptojnë shqip nga mundësia për t'u avancuar. Këto janë mikrokozmos të një problemi shumë më të madh dhe më sistematik kur bëhet fjalë për dygjuhësinë, dhe duket se ekziston një mosgatishmëri kronike për t'u përmbajtur të drejtave gjuhësore në pothuajse të gjitha nivelet e qeverisjes. Një çështje tjetër, që është mbase shumë e gjerë për t'u përshkruar në detaje, është çështja e qasjes në shërbime dhe duket se shpesh komuniteti serb në Kosovë has në pengesa. Një shembull kryesor i kësaj është qasja në dokumente personale identifikuese dhe të shtetësisë, gjë e cila ka vazhduar për shumë vite dhe e cila reflekton probleme më të gjera dhe më të thella në marrëdhëniet midis autoriteteve qeverisëse

22 <http://www.ngoaktiv.org/publication/towards-a-more-equal-reponse-to-the-covid-19-pandemic-in-kosovo>

23 <http://www.ngoaktiv.org/publication/covid-19-between-reality-and-disinformation>

24 <http://www.ngoaktiv.org/publication/covid-19-between-reality-and-disinformation>

dhe komuniteteve jo-shumicë.²⁵ OJQ CPMZ në Gora-zhdec konstatoi se ekziston një numër i madh i të rinjve nga komuniteti serb të cilët prej kohësh nuk ishin në mundësi të marrin dokumente personale për shkak se dokumentet e lëshuara nga institucionet e financuara nga Republika e Serbisë në Kosovë ishin refuzuar.

Sfidat e përshkruara më lart përkeqësohen më tej sepse duket se ekziston një mungesë e përgjithësuar e ndërgjegjësimit rreth dispozitave ligjore dhe kushtetuese dhe rregulloreve për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe mekanizmave (ligjorë dhe institucionalë) të disponueshëm për t'i mbrojtur ato.²⁶ Në themel të të gjithë kësaj, dhe ndoshta për shkak të saj, ekziston një hezitim i mëtejshëm për të krijuar besim në aftësinë e institucioneve dhe autoriteteve për të respektuar të drejtat e komuniteteve dhe individëve. Pyetjet që lindin nga kjo kanë një numër dimensionesh të ndryshme: si i perceptojnë të drejtat e tyre banorët lokalë të komuniteteve dhe zonave jo-shumicë? A konsiderojnë ata që respektohen në nivel institucional dhe a u sigurohet qasja e barabartë në shërbime me pjesëtarët e shumicës? A ekziston një nivel i besimit institucional, që nënkupton se pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë konsiderojnë se politikisht përfaqësohen në mënyrë adekuate dhe se të drejtat e tyre janë më shumë sesa thjesht vetëm fjalë në letër? Ky punim do të përpiket të adresojë këto pyetje përmes një shqyrtimi të hollësishtë të rezultateve të hulumtimit të realizuar nga OJQ Aktiv dhe OJQ CPMZ në periudhën nga korriku deri në nëntor të vitit 2020.

Pandemia COVID-19 dhe të drejtat e komuniteteve

Shfaqja e pandemisë COVID-19 dhe si rezultat gjendja e jashtëzakonshme, izolimi dhe mbyllja e kufijve, në vetvete, nuk shkaktoi probleme në respektimin e të drejtave të komuniteteve në Kosovë. Kjo, megjithatë, çoi në probleme të mëtejshme për grupet jo-shumicë, veçanërisht serbët e Kosovës, në marrëdhëniet e tyre me autoritetet dhe institucionet

25 <http://www.ngoaktiv.org/publication/covid-19-between-reality-and-disinformation>

26 Siç u tha në fokus grupet e mbajtura në komunitat në veri dhe jug të Kosovës në periudhën shtator dhe nëntor 2020.

qeverisë të nivelit qendror. Është raportuar në shumë raste që Qeveria e Kosovës ka dështuar të vendosë kanale koherente, efektive dhe të qëndrueshme të komunikimit me komunitetet jo-shumicë.²⁷ Situata emergjente e shëndetit publik nuk është shkaku kryesor i problemeve në marrëdhëniet midis komuniteteve periferike dhe organeve dhe institucioneve qendrore politike, por përkundrazi mund të thuhet se shërbeu për të hedhur dritë mbi problemet që tashmë ekzistojnë në dinamikën në fjalë.

Rezultatet e sondazheve të opinionit publik mbi perceptimin e të drejtave të komuniteteve

Përmbledhje e rezultateve

Rezultatet e grupeve të fokusit dhe sondazheve të opinionit publik janë kryesisht komplementare dhe, në përgjithësi, konfirmojnë supozimet e mëposhtme:

- Se serbët e Kosovës përgjithësisht janë të painformuar në lidhje me të drejtat e tyre ligjore dhe politike në kuadër të sistemit të Kosovës.
- Se serbët e Kosovës nuk janë të prirur të besojnë se të drejtat e tyre kolektive dhe individuale mbrohen nga dhe në kuadër të sistemit.
- Se serbët e Kosovës nuk janë të prirur të besojnë se ata trajtohen në mënyrë të barabartë nga autoritetet qeverisëse.
- Se serbët e Kosovës besojnë se kanë mjaft të drejta ligjore në letër, por që nuk respektohen në praktikë.
- Se vlerësimet e përvojave me institucione nuk janë më të mirat.

Duhet të theksohet se ka ndryshime rajonale kur bëhet fjalë për perceptimin e të drejtave, njohjet e të drejtave dhe në disa raste, shkallën në të cilën institucionet i respektojnë ato të drejta. Këto ndryshime mund të shpjegohen, të paktën pjesërisht, nga struktura demografike e komunave në të cilat jetojnë pjesëmarrësit: ata që jetojnë në veri të Kosovës ku serbët përbëjnë shumicën absolute dhe ku shumica dërrmuese e punonjësve të sektorit publik ose janë të përkatësisë etnike serbe ose flasin rrjedhshëm

gjuhën serbe, shprehin nivel më të madh të kënaqësisë dhe raportojnë më pak probleme komunikimi me institucionet publike sesa ata që jetojnë në jug të lumit Ibër. Fakti që shumë serbë jetojnë në enklava në komuna me shumicë shqiptare do të thotë që ata kanë kontakte më të shpeshta me institucionet që operojnë brenda kornizës ligjore të Kosovës dhe ndërveprime me pjesëtarët e grupeve të tjera etnike. Përderisa qëndrimet në lidhje me të drejtat e komuniteteve dhe respektimin e të drejtave të komuniteteve mund të jenë të ngjashme në shumë aspekte, serbët që jetojnë jashtë katër komunave veriore kanë përvoja më të drejtpërdrejta dhe personale me shkeljet e tyre.²⁸ Për shembull, pjesëmarrësit e grupeve të fokusit të mbajtura në Kosovën perëndimore dhe lindore përmendën shembuj të drejtpërdrejtë të kontakteve negative me policinë dhe sistemin gjyqësor, ku një grua nga Gjilani përshkroi një situatë në të cilën një zyrtar policor refuzoi t'i drejtohej asaj në gjuhën serbe kur e gjobiti për mosrespektim të masave për mbajtjen e maskave²⁹. Kjo ndryshon nga informacioni i mbledhur në veri të Kosovës, ku pjesëmarrësit në mënyrë tipike deklaruan se 'ata janë në dijeni për probleme, por nuk i kanë përjetuar ato personalisht'.³⁰

Një pikëpamje e përbashkët e cila u nda nga pothuajse të gjithë pjesëmarrësit e grupeve të fokusit (si ekspertë dhe qytetarë) dhe gjithashtu e pasqyruar në hulumtimin e opinionit publik, është se baza ligjore dhe kushtetuese për komunitetet është e mirë, por që zbatimi mungon - një pjesëmarrës tha që *"gjithçka është shkruar mirë në letër, por në terren, në fakt, asgjë nuk zbatohet"*.³¹ Një pjesëmarrës tjetër, aktivist lokal i shoqërisë civile, shkoi më tej në përshkrimin e situatës si *"Një sistem terrori sistematik i organizuar ligjërisht. Si një komunitet jo-shumicë, ne jemi në fund të fundit"*.³² Faji për këtë situatë i atribuohet një numri faktorësh të ndryshëm, nga mungesa e vullnetit politik e deri te diskriminimi i drejtpërdrejtë dhe i vazhdueshëm.

28 Siç pasqyrohet në rezultatet e grupeve të fokusit të mbajtura në Mitrovicën e Veriut, Zveçan, Çagllavicë, Gjilan dhe Gorazhdec në periudhën gusht - tetor të vitit 2020.

29 Siç pasqyrohet në rezultatet e grupeve të fokusit të mbajtura në Mitrovicën e Veriut, Zveçan, Çagllavicë, Gjilan dhe Gorazhdec në periudhën gusht - tetor të vitit 2020.

30


31 Grupi i fokusit i mbajtur në Gjilan më 31 gusht 2020.

32 Grupi i fokusit i mbajtur në Gjilan më 31 gusht 2020.

Besimi në institucionet publike


Rezultatet e hulumtimit sasior dhe cilësor tregojnë një mungesë të madhe besimi në institucionet publike dhe akterët politikë për të ndërmarrë hapa në sigurimin e respektimit të të drejtave në praktikën e përditshme të autoriteteve dhe organeve qeverisëse në Kosovë: Vetëm rreth 11% e të gjithë të anketuarve u pajtuan me deklaratë *Serbët gëzojnë të gjithë të drejtat politike dhe shoqërore të garantuara* për ta ndërsa një shumicë dërrmuese prej më shumë se 70% shprehën një formë mospajtimi.

Grafiku 1. Serbët gëzojnë të gjithë të drejtat politike dhe shoqërore që u garantohen




Siç mund të shihet nga rezultatet e paraqitura më lart, ka pak ndryshime rajonale në lidhje me përgjigjet dhe pikëpamjet e shprehura nga të anketuarit.

Grafiku 2. Konsideroj se të drejtat e mia janë të mbrojtura mirë në Kosovë




Grafiku 3. Konsideroj se të drejtat e mia janë të mbrojtura mirë në Kosovë – veriu karshi jugut



Kur u pyetën nëse ata mendojnë se të drejtat e tyre personale janë të mbrojtura mirë në Kosovë, shumica dërrmuese e të anketuarve (rreth 76%) thanë se nuk e konsiderojnë se ato janë të mbrojtura, ndërsa vetëm një përqindje shumë e vogël shprehën pikëpamjen e kundërt. Prandaj, duket se perceptimi i përgjithshëm është se në kuadër të sistemit nuk mbrohen as të drejtat kolektive dhe as ato individuale. Duhet të theksohet se është një përqindje pak më e ulët e të anketuarve nga komunitetet në jug të lumit Ibër që nuk u pajtuan plotësisht me deklaratën 'Konsideroj se të drejtat e mia personale janë të mbrojtura mirë në Kosovë' në krahasim me përqindjen e të anketuarve në veri (diferenca prej 5.4%). Në përgjithësi, rreth 73% e të anketuarve në jug dhe 81% e të anketuarve në veri nuk pajtohen që të drejtat e tyre janë të mbrojtura mirë në Kosovë. Kjo mund t'i atribuohet, të paktën pjesërisht, faktit që shumica në jug i njohin më mirë të drejtat e tyre sesa ata në veri.


Grafiku 4. Serbët kanë disa të drejta në letër, por jo edhe në praktikë



Grafiku 5. Serbët kanë disa të drejta në letër, por jo edhe në praktikë – veriu karshi jugut

▨ Veriu i Kosovës

■ Komunitat me shumicë serbe në jug të lumit Ibër



Pikëpamja e pasqyruar në rezultatet e ilustruara në grafikun e mësipërm, se ekziston një pabarazi e madhe midis ligjit të shkruar dhe mënyrës se si respektohet në të vërtetë çdo ditë, ndahet jo vetëm nga shumica dërrmuese e publikut të gjerë, por gjithashtu edhe nga ekspertët në fokus grupe dhe pjesëmarrësit e intervistave. Nga kjo del se ekziston një konsensus, siç deklaroi një i intervistuar, që institucioneve publike u mungon ‘vullneti politik’ dhe kapitali për të zbatuar ligjin.

Një tjetër i anketuar thekson se ‘asnjë institucion në Kosovë nuk ka kapacitet teknik ose operacional për të zbatuar ligjet në lidhje me komunitetet jo-shumicë në Kosovë.’ Pothuajse asnjë nga pjesëmarrësit e intervistuar për qëllimet e këtij studimi nuk shprehu pikëpamjen se të drejtat respektohen në praktikë ose se pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë gëzojnë mbrojtje të plotë ligjore të parashikuar nga korniza legjislative dhe kushtetuese.

Qasja në informacion

Rezultatet e sondazhit të opinionit publik tregojnë se vetëvlerësimi i të anketuarve për të drejtat e tyre në kornizën ligjore tregon se njohuritë për të drejtat e komuniteteve jo-shumicë janë

relativisht të dobëta si në thelb ashtu edhe në fushëveprim. Siç mund të shihet në grafikët vijues, vetëm rreth 30% e të anketuarve deklarojnë se janë të vetëdijshëm për të drejtat e tyre kushtetuese.

Figure 6. Unë jam në dijeni të të drejtave të mia të garantuara me Kushtetutën e Kosovës





Figure 7. Unë jam në dijeni të të drejtave të mia të garantuara me Kushtetutën e Kosovës – veriu karshi jugut



Kur u pyet për t'iu përgjigjur deklaratës 'Unë jam në dijeni të të drejtave të mia të garantuara me Kushtetutën e Kosovës' më shumë se gjysma (52.6%) shprehën mospajtim ndërsa një përqindje dukshëm më e vogël (30%) u pajtua. Një përqindje relativisht e lartë (15.6%) deklaruan se ata as pajtohen e as nuk pajtohen, ose nuk pranuan t'i përgjigjeshin pyetjes fare. Mund të shihet më sipër se ka disa ndryshime rajonale, me një numër pak më të lartë të të anketuarve në veri të lumit Ibër që nuk pajtohen me deklaratën në krahasim me ata në jug (57.1% në veri kundrejt 52.1% në jug). Duke supozuar se kjo diferencë është më shumë rezultat i mospërputhjeve aktuale në nivelin e njohurive që posedojnë banorët e veriut kundrejt atyre të komunave të jugut sesa një margjinë statistikore e gabimit, një shpjegim i pjesshëm mund të gjendet në përgjigjet e dhëna gjatë fokus grupeve dhe intervistave: komunitetet këtu janë më të ekspozuara ndaj sistemit të Kosovës dhe në të vërtetë kanë kontakte shumë më të shpeshta me atë sistem, prandaj ata mund të njohin më hollësisht dispozitat ligjore që parashikojnë, për shembull, dygjuhësinë.

Kur bëhet fjalë për rezultatet e hulumtimit cilësor, këtu ka një sasi të caktuar të disonancës midis rezultateve të hulumtimit të opinionit publik dhe përgjigjeve të mbledhura nga fokus grupet, dhe pjesëmarrësit në përgjithësi deklaruan se janë të vetëdijshëm për të drejtat e tyre në kuadër të sistemit ligjor. Kjo pjesërisht i atribuohet faktit që një numër i caktuar i grupeve të fokusit janë mbajtur me ekspertë, por duhet theksuar gjithashtu se ky është një vlerësim shumë subjektiv pasi qëndrimet e bazuara në njohuritë personale mund të ndryshojnë nga personi në person. Pjesëmarrësit e grupeve të fokusit në jug, janë më të vetëdijshëm për të drejtat e tyre sesa ata në veri. Në veri, ekziston një nivel i caktuar i apatisë së shprehur nga pjesëmarrësit duke thënë se nuk janë mjaftueshëm në dijeni por që *'në sistemin aktual ushtrimi i të drejtave është i vështirë'*³³ edhe se nuk e ndiejnë të nevojshme ta

bëjnë këtë.³⁴ Për më tepër, ata duket se kishin një vetëdije të përgjithshme se, për shembull, mund të jetë e vështirë të merren dokumente gjyqësore/ligjore dhe aktgjykime në gjuhën serbe, por vetë pjesëmarrësit në jetën e përditshme nuk kanë pasur përvojë personale me këtë problem.³⁵ Kjo është në kontrast me qëndrimet e shprehura në jug të lumit Ibër, ku pjesëmarrësit jo vetëm që janë më të vetëdijshëm se cilat janë të drejtat e tyre ligjore por gjithashtu kishin përvojë të drejtpërdrejtë me shkeljet e tyre. Siç u tha më parë në këtë analizë, kjo ndoshta është e pritshme duke pasur parasysh përbërjen e komunave individuale të përfshira në studimin në fjalë.

Një çështje e cila duhet të adresohet kur diskutohen dhe analizohen rezultatet e këtij hulumtimi është se të anketuarit besojnë se të drejtat e tyre janë shkelur dhe/ose respektuar, pa ditur se cilat janë ato të drejta: Rreth 52% e të anketuarve deklaruan se nuk ishin në dijeni të të drejtave të tyre kushtetuese, por mbi 70% e tyre deklaruan se këto të drejta ishin shkelur ose nuk ishin të mbrojtura. Kjo sjell në pyetje se si konceptohen të drejtat - në kuptimin e përgjithshëm që ata duhet të kanë të drejta të caktuara, por u mungojnë ose që kanë të drejta dhe se këto të drejta nuk respektohen nga autoritetet qeverisëse. Nga ana tjetër, hulumtimi cilësor zbuloi një shkallë të caktuar të apatisë në mes të pjesëmarrësve, të cilët shpesh deklaruan se ata nuk e shohin qëllimin ose përfitimin e të qenit të vetëdijshëm për të drejtat e tyre ose mekanizmat e tyre mbrojtës pasi sistemi nuk është i gatshëm ose madje i aftë t'i mbrojë ato.³⁶

Lidhur me pyetjen pse banorët, sipas vlerësimit të tyre, janë të painformuar, një pjesë e përgjigjeve të mundshme jepën nga rezultatet e grupeve të fokusit dhe intervistave; aktivistët lokalë të shoqërisë civile, veçanërisht në jug të lbrtit, gjithashtu vunë në dukje se ekziston një 'mungesë interesi' midis banorëve, veçanërisht të

34 IBID

35 Siç u tha nga një pjesëmarrës i fokus grupit të mbajtur në Mitrovicën e Veriut më 6 tetor 2020.

36 IBID

33 Siç u tha gjatë një fokus grupi të mbajtur më 6 tetor 2020.

rinjve, kur bëhet fjalë për përpjekjet për t'u njohur me kornizën ligjore të Kosovës.³⁷ Gjithashtu u theksua se përpjekjet e mëparshme për ngritjen e vetëdijes nuk ishin të frytshme, kryesisht për shkak të rritjes së apatisë midis banorëve të komunitetit lokal.³⁸ Për më tepër, në një numër rastesh të ndryshme, komuniteti serb i Kosovës u përshkrua si 'pasiv' dhe të cilit i mungon vullneti/aftësia për të mbrojtur në mënyrë aktive të drejtat e tij dhe për të "kërkuar drejtësi" - kjo shpesh ishte dhënë si një arsye (e pjesshme) për zbatimin dhe respektimin e dobët të legjisllacionit që rregullon të drejtat e komuniteteve jo-shumicë. Për më tepër, një numër pjesëmarrësish përmendën gjithashtu mungesën e burimeve dhe/ose qasjen në informacion si një arsye për një paqartësi të përgjithshme të specifikave të të drejtave ligjore. Megjithatë disa nga këto qëndrime të artikuluara që mund të përshkruhen gjerësisht si apatike, gjithsesi reflektojnë mungesën e besimit: pjesëmarrës të shumtë të hulumtimit theksuan vazhdimisht faktin se nuk besojnë se institucionet janë në gjendje të mbrojnë të drejtat, e as nuk e kanë vullnetin politik për ta vepruar ashtu.

Besimi në akterët institucionale dhe politikë

Duke iu kthyer pyetjes që u adresua shkurtimisht më lart - asaj të besimit në institucionet publike, duket se do të konfirmon ekzistencën e një atmosfere mosbesimi ndaj institucioneve publike dhe lodhjes kur bëhet fjalë për to. Kjo është më e theksuar kur bëhet fjalë për mekanizmat gjyqësorë dhe policinë.³⁹ Bazuar në intervista, grupe të fokusit dhe veçanërisht në sondazhe të opinionit publik, duket se kjo është kryesisht rezultat i paaftësisë dhe/ose mungesës së vullnetit nga ana e institucioneve të lartpërmendura për të komunikuar dhe ofruar shërbimet e nevojshme në gjuhën serbe dhe për të siguruar që të gjithë banorët e Kosovës

37 IBID

38 Rezultatet e grupeve të fokusit të mbajtura në Graçanicë, Çagllavicë, Mitrovicën Veriut dhe në rajonin e Gjilanit në periudhën shtator dhe tetor 2020.

39 Siç u tha nga pjesëmarrësit e fokus grupit të mbajtur në Çagllavicë më 6 tetor 2020.

kanë qasje të barabartë dhe të papenguar në shërbimet publike. Disa nga këto i atribuohen përvojës së drejtpërdrejtë dhe negative me autoritetet, veçanërisht institucionet e 'vijës së parë' siç janë policia, sistemi gjyqësor dhe institucionet lokale/komunale dhe burokracitë e tjera të përditshme.⁴⁰ Fakti që ata hasin vështirësi në përmbushjen edhe të detyrave më themelore, të tilla si aplikimi për dokumente identifikimi ose patentë shoferi forcon një perceptim të trajtimit të papabarabartë dhe nënshtrimit ndaj një forme diskriminimi de facto që, me qëllim ose jo, zvogëlon mundësinë që ata plotësisht të marrin pjesë në jetën institucionale dhe publike.⁴¹

Një çështje tjetër që nuk u adresua në hulumtimin cilësor, por që u mbulua gjatë diskutimeve të shumta me të intervistuarit dhe grupet e fokusit, është ajo e përfaqësimit politik dhe efikasitetit të akterëve politikë serbë në Kosovë në zgjidhjen e problemeve me të cilat përballen në zonat e tyre elektorale në mënyrë sistematike dhe/ose holistike. Duket se ekziston një qëndrim i përgjithshëm (midis qytetarëve) se politikanët motivohen kryesisht nga interesi vetjak, dhe jo nga interesat e zgjedhësve të tyre - duke çuar në një situatë ku injorohen abuzimet e të drejtave dhe/ose shkeljet e tyre.⁴²

Përvoja institucionale


Kur bëhet fjalë për ndërveprime dhe përvojë aktuale me institucionet publike dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve të drejtuara nga qeveria, rezultatet dhe qëndrimet shpesh janë të përziera. Gjithsej 47% e të gjithë të anketuarve në sondazhet e opinionit publik deklaruan se kanë përvojë në një situatë ku nuk ishin në gjendje t'i qaseshin një shërbimi të caktuar të ofruar nga një institucion publik, ndërsa 46% thanë se nuk kishin.

40 IBID

41 Siç pasqyrohet në deklaratat e bëra gjatë grupeve të fokusit me ekspertë dhe aktivistë të shoqërisë civile në Çagllavicë dhe Graçanicë, të mbajtura me datë 6 tetor 2020 dhe në fokus grupe të mbajtura në veri të Kosovës.


42 Rezultatet e grupeve të fokusit të mbajtura në Graçanicë, Çagllavicë, Mitrovicën Veriut dhe në rajonin e Gjilanit në periudhën shtator dhe tetor 2020.

- Grafiku 8.** A keni qenë ndonjëherë në një situatë ku nuk keni pasur qasje në shërbimet e ofruara nga një institucion publik?



Fakti që pothuajse gjysma e të gjithë të anketuarve pretendojnë se kishin përjetuar një situatë ku nuk kanë pasur qasje në shërbime është në përputhje me deklaratat e dhëna në intervista dhe grupe të fokusit, që në rastin më të mirë, tregojnë një ambivalencë kur bëhet fjalë për institucionet publike dhe në rastin më të keq, armiqësinë dhe/ose dyshimin për shkak të perceptimit të trajtimit të pabarabartë.

- Grafiku 9.** A keni qenë ndonjëherë në një situatë ku nuk keni pasur qasje në shërbimet e ofruara nga një institucion publik? Veriu karshi jugut




Siç mund të shihet në grafikun e mësipërm, ekziston një diferencim i vogël midis përvojave të të anketuarve në veri dhe jug: një përqindje pak më e lartë (50.7%) e banorëve në jug të lumit Ibër raportuan të paktën një rast ku ata nuk kishin qasje në shërbime, ndërsa një përqindje më e ulët (44.3%) e banorëve të veriut kishin të njëjtën përvojë. Kjo ishte diçka që u pasqyrua edhe në fokus grupe, siç thuhet në veri në një numër

rastesh se ndërveprimi me institucionet ishte i kufizuar ⁴³, dhe komunat ishin me shumicë serbe. Sidoqoftë, banorët e komunave me shumicë shqiptare, si Peja, kanë tendencën të kenë më së shumti probleme me bashkëveprim me institucione dhe qasje në shërbime dhe informacione në gjuhën serbe. ⁴⁴⁴⁵

Përvojat negative me organet shtetërore mund të jenë të vështira për t'u karakterizuar nga një individ dhe në të vërtetë, mund të jetë i paqartë kufiri midis refuzimeve zhgënjyese por megjithatë legjitime për shërbime të caktuara ose qasje në dokumente të caktuara dhe formave të ndryshme të diskriminimit. Kjo çështje mund të sqarohet më tej bazuar në të dhënat në grafikun vijues:

Grafiku 10. Pse nuk mund t'iu qaseshit atyre shërbimeve?



Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve që deklaruan se nuk kishin mundësi t'iu qaseshin shërbimeve në institucion, rreth 30% fajësuan mungesën e informacionit të disponueshëm ose komunikimit në gjuhën e tyre ndërsa 13.4% thanë se atyre iu ishte refuzuar ndihma për arsye të panjohura për ta, dhe 17.5% thanë se nuk posedonin dokumentacione e nevojshëm. Kjo, në shumë mënyra, është në përputhje me hulumtimet dytësore dhe në terren të kryera për këtë studim që vunë në dukje një numër të madh sfidash me të cilat përballen serbët e Kosovës në lidhje me të drejtat gjuhësore si dhe qasjen në dokumente.

Megjithëse shumë pjesëmarrës në hulumtim shprehën pikëpamjen se qeveritë lokale janë më të përgjegjshme ndaj nevojave të tyre sesa ato të nivelit qendror, Kuvendi i Kosovës u veçua si një organ që vazhdimisht shkel Ligjin për përdorimin e gjuhëve, dhe në një fokus grup u tha që Zyra e Presidentit ishte një shembull pozitiv i një institucioni që respekton të drejtat gjuhësore dhe të drejtat tjera. Për më tepër, shumë banorë, si 'ekspertë' dhe të tjerë, që kishin pasur kontakt me mekanizma të tillë si ai i Institutit të Avokatit të Popullit deklaruan se përvojat e tyre ishin kryesisht pozitive dhe se i njëjti me sukses ofroi ndihmën adekuate.

43 IBID

44 Rezultatet e grupeve të fokusit të mbajtura në Graçanicë, Çagllavicë, Mitrovicën e Veriut dhe në rajonin e Gjilanit në periudhën shtator dhe tetor 2020.

45 Siç u tha gjatë një fokus grupi të mbajtur në Pejë në tetor 2020.

5. Përfundimet

Ky hulumtim konfirmoi shumë nga supozimet e mëparshme të bëra nga përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe akterët e tjerë të rëndësishëm - se ekziston një perceptim i rrënjësor dhe i përhapur në mesin e popullatës së përgjithshme që ata nuk mund të mbështeten tek qeveria për ofrimin e të gjitha të drejtave të premtuara në legjislacion, gjë që konfirmohet nga praktika institucionale. Kjo çon në një lloj ndarjeje të popullsisë dhe të institucioneve e politikanëve që kanë për qëllim të përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e tyre. Ndjenjat e përjashtimit dhe izolimit përkeqësohen nga një situatë ku qytetarët nuk mendojnë se mund të mbështeten tek autoritetet për t'u siguruar atyre kushtet për krijimin dhe përmirësimin e një jete normale,



Fakti që, në përgjithësi, ekziston të paktën një njohje e përgjithshme që Kushtetuta e Kosovës dhe ligjet teorikisht ofrojnë mbrojtje të mjaftueshme për komunitetet jo-shumicë dhe u sigurojnë atyre hapësirë të mjaftueshme në çështjet e komunitetit dhe forcimin e identitetit të tyre, është ndoshta shprehje e një shkalle të gatishmërisë për t'u angazhuar me autoritetet në përmirësimin e marrëdhënieve të tyre me grupet e pakicave

dhe pjesëmarrjen në mekanizmat demokratikë. Pavarësisht nga sa më sipër, nuk mund të pretendohet se nuk ka "shembuj të ndritshëm" ose se situata është plotësisht e pariparueshme. Fakti që, në përgjithësi, ekziston të paktën një njohje e përgjithshme që Kushtetuta e Kosovës dhe ligjet teorikisht ofrojnë mbrojtje të mjaftueshme për komunitetet jo-shumicë dhe u sigurojnë atyre hapësirë të mjaftueshme në çështjet e komunitetit dhe forcimin e identitetit të tyre, është ndoshta shprehje e një shkalle të gatishmërisë për t'u angazhuar me autoritetet në përmirësimin e marrëdhënieve të tyre me grupet e pakicave. Për më tepër, pjesëmarrësit në hulumtim në disa raste pa hezitim theksuan përvojat më pozitive që kishin, që do të thotë se ata janë të gatshëm të njohin sukseset kur ato ndodhin. Ajo që mbetet për t'u parë është nëse qytetarët dhe grupet që i përfaqësojnë ata do të jenë në gjendje ose jo të vendosin një koordinim dhe bashkëpunim të mjaftueshëm në krijimin e entuziazmit publik për nxitjen e ndryshimeve pozitive. Kjo është diçka që do të varet nga një numër faktorësh, por nëse do të ndodhë do të krijojë ndryshime konstruktive në natyrën e marrëdhënieve midis autoriteteve qeverisëse të nivelit qendror dhe komuniteteve jo-shumicë dhe do të mundësojë pjesëmarrje më të madhe dhe më aktive në jetën publike në Kosovë.

Rekomandime

- **Qeveria e Kosovës, në bashkëpunim me institucione të tilla si Institucioni i Avokatit të Popullit dhe Zyra e Komisionerit për Gjuhët,** duhet të fillojnë fushata afatgjate dhe agresive të informimit publik në zonat me shumicë serbe të Kosovës me qëllim të rritjes së nivelit të ndërgjegjësimit jo vetëm për të drejtat e tyre politike dhe sociale por edhe të mekanizmave që ekzistojnë për t'i mbrojtur ato.
- Qeveria e Kosovës duhet të ndërmarrë hapa konkretë për krijimin e një baze të unifikuar të të dhënave, **në formën e një aplikacioni Android/IOS** që do të përmbajë informacion mbi hapat specifikë që duhen të ndiqen në rast të shkeljes së të drejtave.
- **Çdo institucion publik (vendor dhe qendror)** duhet të ndërmarrë hapa për të siguruar që informacioni mbi të drejtat e përdoruesve të shërbimeve është publik dhe i disponueshëm, si në letër ashtu edhe në formë elektronike.
- **Qeveria duhet të** bashkëveprojë më ngushtë dhe më shpesh me komunitetet jo-shumicë përmes takimeve gjysmë-formale me OSHC-të lokale dhe grupe të tjera të qytetarëve për krijimin e besimit. Për shembull, qeveria mund dhe duhet të fasilitojë takimet ndërmjet përfaqësuesve të Policisë së Kosovës dhe pjesëtarëve të komuniteteve të ndjeshme, veçanërisht atyre të kthyerve.
- **Duhet të themelohet një grup punues që do të përbëhet nga pjesëtarë të forcës policore, përfaqësues politikë të komuniteteve serbe të Kosovës (në nivelin lokal dhe qendror)**

dhe shoqërisë civile. Një grup i tillë duhet të formohet nën kujdesin e Ministrisë së Punëve Brendshme dhe Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, dhe të zhvillojë takime të rregullta. Ky do të ishte një mjet për krijimin e një linje të drejtpërdrejtë të kontaktit midis komuniteteve lokale dhe qeverisë qendrore;

- Qeveria e Kosovës dhe Ministritë duhet të vendosin kanale të qarta dhe të qëndrueshme të komunikimit me mediat në gjuhën serbe dhe OSHC-të ku duhet të krijohet **një mekanizëm i përhershëm ndërlidhës për të lehtësuar një komunikim më efektiv dhe të frytshëm. Kjo duhet të ndodhë deri në nëntor të vitit 2020, para një 'vale të ardhshme' të mundshme të infeksionit.**

Rreth nismës

"Demokracia, hapja dhe perspektiva e komunitetit serb në Kosovë - Open" është një nismë e re e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), e filluar në vitin 2020. Open zbatohet në bashkëpunim me nëntë organizata të shoqërisë civile që veprojnë në komunitetin serb në Kosovë.

Qëllimi i përgjithshëm i nismës së re është të zhvillojë një hapësirë të hapur dhe dinamike për diskutim brenda komunitetit serb, në mes të komunitetit serb dhe komuniteteve të tjera, si dhe institucioneve në Kosovë.

- Nisma do të adresojë në mënyrë specifike analizën dhe vlerësimin e ndikimit të organizatave civile dhe politike mbi demokracinë dhe hapjen e komunitetit serb në Kosovë.
- Do të analizohen dhe vlerësohen demokracia dhe hapja e institucioneve, politikave publike dhe proceset e rëndësishme ndaj komunitetit serb në Kosovë, si dhe shkalla e hapjes së komunitetit serb ndaj tyre.
- Këto analiza do të ndihmojnë për të kuptuar gjendjen aktuale dhe perspektivat e komunitetit serb në Kosovë, përderisa në të njëjtën kohë do shërbejnë si bazë për përfaqësim argumentues ndaj qytetarëve, institucioneve të qeverisë lokale dhe qendrore si dhe bashkësisë ndërkombëtare.

Organizatave me përvojë dhe të dëshmuara të shoqërisë civile, për të arritur qëllime të përgjithshme dhe specifike do të realizojnë tetë (8) analiza sektoriale.

Fushat që partnerët tanë do të analizojnë në vitin 2020 janë:

Mediat Sa ndikojnë mediat në gjuhën serbe në Kosovë në shkallën e hapjes, qasjes dhe pluralizmit të opinionëve dhe temave? Kjo fushë hulumtohet nga **Qendra Mediale** dhe **Bota bardh e zi**.

Shoqëria civile Si kontribuojnë organizatat e shoqërisë civile në hapjen dhe demokracinë e komunitetit serb dhe shoqërisë në Kosovë në përgjithësi? Me këtë temë merret **Iniciativa e re shoqërore** dhe **Forumi për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multietnik**.

Partitë politike Demokracia dhe pluralizmi i partive politike serbe të Kosovës, hapja e tyre për të marrë pjesë në sistemin politik të Kosovës dhe për të kontribuar në avancimin dhe përmirësimin e politikave publike. Në këto çështje do të fokusohet **Iniciativa e re shoqërore** dhe **Qendra Mediale**

Përgjegjësia e institucioneve Përmes monitorimit të kuptohet më mirë pozita e komunitetit serb në Kosovë dhe se sa të hapur janë institucionet ndaj problemeve të serbëve. Analiza realizohet nga **Bota bardh e zi** dhe **Forumi për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multietnik**.

Siguria Sa ndikon ndjenja e sigurisë në hapjen e komunitetit serb ndaj institucioneve të sigurisë së Kosovës? Në këtë pyetje kërkon përgjigje **Qendra Humane Mitrovica**.

Ekonomia Sa janë të hapura entitetet ekonomike nga komunitetet me shumicë serbe për integrim në ekonominë e Kosovës? Këtë fushë e analizon **Instituti për Zhvillimin Ekonomik Territorial (InTER)**.

Të drejtat e pakicave Si të arrihet një shoqëri më e hapur duke vënë në pah boshllëqet në zbatim të së drejtave të pakicave? Kjo temë shqyrtohet nga **OJQ Aktiv** dhe **Qendra për të Drejtat e Komuniteteve të Pakicave**

Procesi i dialogut dhe normalizimi i marrëdhënieve

Kosovë-Serbi - Deri në çfarë mase përfaqësohet dhe cilat janë qëndrimet e komunitetit serb të Kosovës lidhur me ndikimin dhe të ardhmen e procesit? Kjo analizë realizohet nga **OJQ Aktiv** dhe **Forumi për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multietnik**.

Në fund të ciklit Open 2020 do të publikohet raporti i konsoliduar „**Karakteristikat e shoqërisë së hapur në komunitetin serb të Kosovës**“ duke i vendosë rezultatet dhe përfundimet e analizave bazë të anëtarëve të iniciativës Open në një kontekst më të gjërë socio-politik të Kosovës.

Iniciativa Open është e përkrahur nga KFOS

